

<b>Para</b>	<b>SKK 2 “PARAQITJA E PASQYRAVE FINANCIARE” – PËRDITËSUAR (2023)</b>
	<b>OBJEKTIVAT DHE BAZAT E PËRGATITJES</b>
1	Objekti i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 2 <i>Paraqitja e Pasqyrave Financiare</i> (SKK 2), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga ministri përgjegjës për financat, është të japë konceptet dhe rregullat-bazë për paraqitjen e informacionit financiar në pasqyrat financiare të hartuara në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimeve financiare të pranura në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të cilave përshkruhen në Ligjin për kontabilitetin.
2	Kërkesat e SKK 2 korrespondojnë me disa paragrafë të SNRF për NVM-të (2015). Standardi bazohet në: Seksioni 3 – <i>Paraqitja e Pasqyrave Financiare</i> Seksioni 4 – <i>Pasqyra e Pozicionit Financiar</i> Seksioni 5 - <i>Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse dhe Pasqyra e të Ardhurave</i> Seksioni 6 - <i>Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto dhe Pasqyra e të ardhurave dhe fitimeve të pashpërndara</i> Seksioni 7- <i>Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare</i> Seksioni 8 - <i>Shënimet e pasqyrave financiare</i> . Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të SNRF për NVM (2015), paraqitet në paragrafin 97. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 2 i ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësive ekonomike duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (KKK) të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të njësive ekonomike, siç kërkohet në Ligjin për kontabilitetin.
	<b>FUSHA E ZBATIMIT</b>
3	Kërkesat e SKK 2, <i>Paraqitja e pasqyrave financiare</i> , do të zbatohen në të gjitha pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.
	<b>PËRKUFIZIMET KRYESORE</b>
4	Më poshtë jepen përkufizimet e disa termave kryesore të përdorura në këtë standard. <b><i>Pasqyra e Pozicionit Financiar</i></b> - Pasqyra financiare që paraqet marrëdhënien e aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit të një njësie ekonomike në një datë të caktuar (njohur më parë si <b><i>bilanci</i></b> ).  <b><i>Pasqyra e Performancës</i></b> - Pasqyra financiare që tregon performancën ekonomike (të ardhurat, shpenzimet, fitimin/humbjen e vitit dhe të ardhurat gjithëpërfshirëse) të një njësie ekonomike gjatë një periudhe kontabël. Ky set është i përbërë nga dy pasqyra:  * <b><i>Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve</i></b> - Pasqyra financiare që paraqet të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura gjatë periudhës, me përjashtim të zërave të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. * <b><i>Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse</i></b> - Pasqyra financiare që paraqet si rresht të parë fitim/humbjen e vitit dhe më pas të gjithë zërat e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse që sjellin ndryshime në kapital.  <b><i>Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto</i></b> - Pasqyra financiare që paraqet fitimin ose humbjen e vitit, zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të cilat ndikojnë direkt në kapital për periudhën, efektet e ndryshimeve në politikat kontabël, korigjimet e gabimeve për periudhën si dhe vlerat e transaksioneve me kapitalin e vet.  <b><i>Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare</i></b> - Pasqyra financiare që paraqet informacion mbi ndryshimet në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare për periudhën, duke e paraqitur këtë informacion në tre pjesë: aktiviteti i shfrytëzimit, i investimit dhe i financimit.  <b><i>Shënimet shpjeguese</i></b> - Pasqyra financiare që paraqet informacion shtesë, përveç atij të paraqitur në pasqyrat e mësipërme.
	<b>Materialiteti</b>
5	Pasqyrat financiare do të përgatiten mbi bazën e konceptit të materialitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nuk do të zbatohen për zërat jomateriale. Parimi i materialitetit përkufizohet dhe sqarohet në paragrafët 64 deri 68 të SKK 1.

6	Konsiderohen materiale mosraportimet ose deklarimet e gabuara të zërave, nëse ato në mënyrë individuale ose të grupuara mund të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra mbi bazën e pasqyrave financiare. Materialiteti varet nga madhësia dhe natyra e mosveprimeve ose deklarimeve të gabuara të gjykuara në rrethanat aktuale. Madhësia ose natyra e zërit, ose një kombinim i të dyjave mund të jetë faktori përcaktues i materialitetit.
7	Një njësi ekonomike duhet të paraqesë veçmas secilën klasë materiale të zërave të ngjashëm. Një njësi ekonomike duhet të paraqesë veçmas artikuj të një natyre ose funksioni të ndryshëm, përveçse kur ata janë jomaterialë.
	<b>PARAQITJA E VËRTETË DHE E DREJTË</b>
8	Një paraqitje e vërtetë dhe e drejtë kërkon një regjistrim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes së aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve të përcaktuara në SKK 1 <i>Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare</i> . Zbatimi i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, me dhënie informacionesh shpjeguese shtesë kur është e nevojshme, supozohet të rezultojë në pasqyra financiare që arrijnë një paraqitje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike. Dhënia e informacioneve shpjeguese shtesë të përmendura më sipër është e nevojshme kur pajtueshmëria me kërkesat specifike në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit është e pamjaftueshme për t'i mundësuar përdoruesit të kuptojnë efektin e transaksioneve të veçanta, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në pozicionin financiar dhe performancën financiare të njësisë ekonomike.
	<b>Pajtueshmëria me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit</b>
9	Një njësi ekonomike, pasqyrat financiare të së cilës janë në përputhje me SKK-të, duhet të japë në shënimet shpjeguese një deklaratë të qartë dhe pa rezerva të kësaj pajtueshmërie.
10	Në rrethana jashtëzakonisht të rralla në të cilat drejtuesit e njësisë ekonomike konstatojnë se përputhshmëria me dispozita të caktuara të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit nuk bën të mundur paraqitjen e vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe flukseve të mjeteve monetare, atëherë drejtuesit duhet t'i përgatisin pasqyrat financiare në bazë të kërkesës për një paraqitje të vërtetë dhe të drejtë siç kërkohet nga paragrafi 8 i SKK 1 <i>Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare</i> .
11	Kur një njësi ekonomike niset nga një kërkesë e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit në përputhje me paragrafin 10, ajo duhet të japë informacionet shpjegues në vijim: (a) se drejtimi ka arritur në përfundimin se pasqyrat financiare paraqesin besnikërisht pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare të njësisë ekonomike; (b) se raportimi është në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, përjashtuar rastet kur ka devijuar nga ndonjë kërkesë e veçantë për të arritur një paraqitje të vërtetë e të drejtë; (c) natyrën e devijimit, duke përfshirë: - trajtimin që Standardet Kombëtare të Kontabilitetit do të kërkonin; - arsyen se pse trajtimi do të ishte kaq çorientues në rrethana të caktuara sa do të binte ndesh me objektivin e pasqyrave financiare të përcaktuara në paragrafin 5 deri 11 të SKK 1 <i>Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare</i> ; dhe - trajtimin e zbatuar;
12	Kur një njësi ekonomike devijon nga një kërkesë e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit në një periudhë të mëparshme dhe ky devijim ndikon shumë e njohura në pasqyrat financiare të periudhës aktuale, njësi do të japë informacionet shpjeguese të përcaktuara në paragrafin 11(c).
	<b>Parimi i Vijimësisë</b>
13	Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i një njësie ekonomike që përdor Standardet Kombëtare të Kontabilitetit duhet të bëjë një vlerësim të aftësisë së njësisë ekonomike për të vazhduar në vijimësi. Një njësi ekonomike është në vijimësi derisa drejtimi të ketë ndërmend të likuadojë njësinë ekonomike ose të ndërpresë operacionet, kur nuk ka ndonjë alternativë tjetër realiste por vetëm të veprojë në këtë mënyrë. Në vlerësimin nëse supozimi i vijimësisë është i përshtatshëm, drejtimi merr parasysh të gjitha informacionet në dispozicion në lidhje me të ardhmen, e cila nënkupton një periudhë, të paktën dymbëdhjetë muaj mbas datës së raportimit.
14	Kur një njësi ekonomike nuk përgatit pasqyra financiare mbi baza vijimësie, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt, së bashku me bazën mbi të cilën ajo i përgatit pasqyrat financiare dhe arsyen pse njësi ekonomike nuk është konsideruar në vijimësi.
15	Kur vlerëson vijimësinë, nëse drejtuesit janë në dijeni mbi pasiguritë materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e njësisë ekonomike për të vazhduar në vijimësi, njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese mbi këto pasiguri.
	<b>Qëndrueshmëria e Paraqitjes</b>
16	Një njësi ekonomike do të ruajë paraqitjen dhe klasifikimin e zërave në pasqyrat financiare nga njëra periudhë në tjetrën derisa:

	<p>(a) të jetë evidente që, pas një ndryshimi të rëndësishëm në natyrën e operacioneve të njësisë ekonomike ose rishikimi të pasqyrave të saj financiare, një tjetër paraqitje apo klasifikim do të konsiderohej më i përshtatshëm duke u nisur nga kriteret për përzgjedhjen dhe zbatimin e politikave kontabël në paragrafët 87 deri 93 të SKK 1 <i>Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e pasqyrave financiare</i>; ose</p> <p>(b) Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të kërkojnë një ndryshim në paraqitje.</p>
17	<p>Kur paraqitja ose klasifikimi i zërave në pasqyrat financiare ndryshohet, një njësi ekonomike do të riklasifikojë shumat krahasuese derisa riklasifikimi të jetë i pazbatueshëm. Kur shumat krahasuese riklasifikohen, njësia ekonomike duhet të japë informacionet shpjeguese në vijim:</p> <p>(a) natyrën e riklasifikimit;</p> <p>(b) shumën e çdo zëri ose çdo klase të zërave të riklasifikuar;</p> <p>(c) arsyen e riklasifikimit.</p>
18	<p>Nëse riklasifikimi i shumave krahasuese është i pazbatueshëm, një njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese se përse riklasifikimi nuk është i mundur.</p>
	<p><b>Informacioni krahasues</b></p>
19	<p>Përveç rastit kur Standardet Kombëtare të Kontabilitetit lejojnë ose kërkojnë ndryshe, një njësi ekonomike duhet të japë shpjegime mbi informacionin krahasues në lidhje me periudhën e mëparshme, të krahasueshme për të gjitha shumat e paraqitura në pasqyrat financiare të periudhës aktuale. Një njësi ekonomike do të përfshijë informacion krahasues për informacionin përshkrues në rastet kur këto shpjegime janë të rëndësishme për të kuptuar pasqyrat financiare të periudhës aktuale.</p>
	<p><b>PËRMBAJTJA E PASQYRAVE FINANCIARE DHE KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR PËRGATITJEN E TYRE</b></p>
20	<p>Një set i plotë i pasqyrave financiare të një njësie ekonomike do të përfshijë të gjitha nga sa vijon:</p> <p>(a) pasqyrën e pozicionit financiar në datën e raportimit;</p> <p>(b) pasqyrën e performancës që përbëhet nga një pasqyrë e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe një pasqyrë e të ardhurave gjithëpërfshirëse;</p> <p>(c) pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto për periudhën;</p> <p>(d) pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për periudhën;</p> <p>(e) shënimet shpjeguese, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera;</p>
21	<p>Nëse një njësi ekonomike nuk ka zëra të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në ndonjë nga periudhat për të cilat janë paraqitur pasqyrat financiare, mund të paraqesë vetëm një pasqyrë të të ardhurave dhe shpenzimeve ku reshti i fundit emërtohet “fitim” ose “humbje”.</p>
22	<p>Duke qenë se paragrafi 19 kërkon shumat krahasuese lidhur me periudhën e kaluar, për të gjitha shumat e paraqitura në pasqyrat financiare, një grup i plotë i pasqyrave financiare nënkupton që një njësi ekonomike duhet të paraqesë minimumi informacionin për 2 vite, për secilën prej pasqyrave financiare të kërkuara dhe shënimet përkatëse të tyre.</p>
23	<p>Në një set të plotë të pasqyrave financiare, një njësi ekonomike duhet t’i kushtojë të njëjtën rëndësi paraqitjes së çdo pasqyre financiare.</p>
24	<p>Ky standard përshkruan kërkesa të përgjithshme, në lidhje me paraqitjen e pasqyrave financiare, si dhe natyrën e informacionit që duhet të jepet në shënimet shpjeguese të tyre. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit mund të vendosë kërkesa shtesë, përse u përket informacioneve që duhet të jepen në shënimet shpjeguese të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit.</p>
25	<p>Në përputhje me kërkesat e Ligjit për kontabilitetin, pasqyrat financiare paraqiten në lekë, duke treguar shkallën e rumbullakimit të shifrave (për shembull, në mijë lekë).</p>
26	<p>Një njësi ekonomike do të identifikojë qartë secilën prej pasqyrave financiare dhe shënimet e tyre shpjeguese duke i dalluar ato nga çdo informacion tjetër jashtë këtij seti pasqyrash. Përveç kësaj, për të kuptuar qartë informacionin e paraqitur në pasqyrat financiare, njësia ekonomike duhet të paraqesë informacionin e mëposhtëm dhe ta përsërisë atë kur është e nevojshme:</p> <p>(a) informacioni i nevojshëm për të identifikuar njësinë ekonomike:</p> <p>(i) emri i njësisë ekonomike dhe çdo ndryshim në emrin e saj që nga fundi i periudhës së mëparshme;</p> <p>(ii) regjistri ku mbahen të dhënat për njësinë ekonomike</p> <p>(iii) numri që ka njësia ekonomike në regjistrin tregtar</p> <p>(b) nëse pasqyrat financiare mbulojnë njësi ekonomike individuale ose një grup të njësisë ekonomike;</p> <p>(c) datën e përfundimit të periudhës raportuese dhe periudhën e mbuluar nga pasqyrat financiare;</p> <p>(d) monedhën e paraqitjes (lekë), siç përcaktohet në paragrafin 25 të këtij Standardi.</p> <p>(e) nivelin e rumbullakosjes, nëse ka, i përdorur në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare.</p>
27	<p>Një njësi ekonomike duhet të japë informacionet e mëposhtëme në shënimet shpjeguese:</p>

	<p>(a) vendbanimin dhe formën ligjore të njësisë ekonomike, vendin e themelimit dhe adresën e zyrës së saj të regjistruar ose selinë e aktivitetit, nëse është e ndryshme nga zyra e saj e regjistruar;</p> <p>(b) një përshkrim të natyrës së operacioneve të njësisë ekonomike dhe aktiviteteve kryesore të saj.</p>
28	<p>Një njësi ekonomike duhet të paraqesë një set të plotë të pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionin krahasues (shih paragrafin 19), të paktën një herë në vit, siç kërkohet nga Ligji për kontabilitetin. Kur fundi i periudhës raportuese të një njësie ekonomike ndryshon dhe pasqyrat financiare vjetore paraqiten për një periudhë më të gjatë ose më të shkurtër se sa një vit, njësia ekonomike duhet të japë informacionet shpjeguese në vijim:</p> <p>(a) faktin në vetvete;</p> <p>(b) arsyen për të përdorur një periudhë më të gjatë ose më të shkurtër;</p> <p>(c) faktin që shumat krahasuese të paraqitura në pasqyrat financiare (duke përfshirë edhe shënimet përkatëse) nuk janë plotësisht të krahasueshme.</p>
<b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR</b>	
<b>Rregulla të Përgjithshme</b>	
29	<p>a) Pasqyra e pozicionit financiar paraqet informacionin mbi pozicionin financiar të njësisë ekonomike në fund të periudhës raportuese;</p> <p>b) Në pasqyrën e pozicionit financiar tepricat e çeljes për çdo periudhë raportuese duhet të korespondojnë me tepricat e mbylljes së periudhës raportuese paraardhëse;</p> <p>c) Pasqyra e pozicionit financiar ka tre përbërës kryesorë:</p> <p>(i) aktivet që kontrollojnë njësia ekonomike;</p> <p>(ii) detyrimet që duhet të përmbushë njësia ekonomike;</p> <p>(iii) kapitalin e pronarëve të njësisë ekonomike.</p>
30	Njësitë ekonomike (përveç njësive të përmendura në paragrafin 38) do të përdorin formatin e pasqyrës së pozicionit financiar të dhënë në <i>Shtojcën 1</i> të këtij Standardi.
31	Kategoritë e zërave të aktiveve dhe detyrimeve në pasqyrën e pozicionit financiar ( <i>paraqitur me ngjyrë të zezë të theksuar në Shtojcën 1</i> ) duhet të respektohen, megjithëse mund të shtohen zëra të tjerë, nëse ata ndikojnë në përmirësimin e qartësisë dhe lexueshmërisë së pasqyrës së pozicionit financiar. Nënkategoritë e pasqyrës së pozicionit financiar mund të paraqiten në shënimet shpjeguese, në vend që të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar. Duke u bazuar në konceptin e materialitetit, zërat jomaterialë mund të paraqiten të grupuar.
32	Kur një aktiv ose detyrim lidhet me më shumë se një zë të caktuar në pasqyrën e pozicionit financiar, marrëdhënia e tij me zërat e tjerë do të shpjegohet në shënimet që shoqërojnë pasqyrat financiare.
33	Të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme dhe të drejta të tjera të ngjashme do të paraqiten nën zërin “Toka dhe ndërtesa”.
34	Kur shuma për shlyerjen e një huaje është më e madhe se vlera e huasë, njësia ekonomike i kërkohet ta paraqesë diferencën si një aktiv. Diferenca mund të tregohet në pasqyrën e pozicionit financiar ose tek shënimet shpjeguese. Diferenca pakësohet çdo vit me një shumë të arsyeshme dhe shuarja e plotë bëhet jo më vonë se shlyerja e huasë.
35	Nënkategoritë e zërave në pasqyrën e pozicionit financiar (paraqitur me shkrim të pjerrët) mund të kombinohen dhe të tregohen në total kur:
	<p>(a) ato janë jomateriale në vlerë; ose</p> <p>(b) një kombinim i tillë jep një qartësi më të madhe, me kusht që zërat e kombinuar në këtë mënyrë të trajtohen veças në shënimet shpjeguese.</p>
36	<p>Një njësi ekonomike me kapital aksionar jep informacion, ose në pasqyrën e pozicionit financiar ose në shënimet shpjeguese, për çështjet në vijim:</p> <p>(a) për secilën klasë të kapitalit aksionar;</p> <p>(i) numrin e aksioneve të autorizuara;</p> <p>(ii) numrin e aksioneve të emetuara dhe të paguara plotësisht ose të emetuara por jo të paguara plotësisht;</p> <p>(iii) vlerën nominale për aksion;</p> <p>(iv) rakordimin e numrit të aksioneve në qarkullim në fillim dhe në fund të periudhës;</p> <p>(v) të drejtat, preferencat dhe kufizimet referuar asaj klase, duke përfshirë kufizimet mbi shpërndarjen e dividendëve dhe ripagesat e kapitalit;</p> <p>(vi) aksionet e njësisë ekonomike të mbajtura nga njësia ekonomike, nga filialet ose pjesëmarrjet e saj;</p> <p>(vii) aksionet e rezervuara për emetim sipas opsioneve dhe kontratave për shitjen e aksioneve, përfshirë afatet dhe shumat;</p> <p>(b) një përshkrim të rezervës brenda kapitalit neto.</p>
37	<p>Një njësi ekonomike pa kapital aksionar si p.sh, një ortakëri ose njësi ekonomike me përgjegjësi të kufizuar, duhet të japë informacion të njëjtë me atë që kërkohet nga paragrafi 33</p> <p>(a), duke treguar ndryshimet gjatë periudhës në secilën kategori të kapitalit dhe të drejtat, preferencat apo kufizimet që shoqërojnë çdo kategori të kapitalit neto.</p>

	<b>Formate të veçanta të pasqyrës së pozicionit financiar</b>
38	Një njësi ekonomike mund të përdorë një format të pasqyrës së pozicionit financiar të ndryshëm nga ai që është dhënë në <i>shtojcën 1</i> të këtij Standardi, nëse ai format është i përshtatshëm për natyrën e veprimtarisë së shfrytëzimit të kësaj njësie (p.sh. njësitë e lizingut, organizatat jofitimprurëse dhe institucionet shtetërore).
39	Nëse njësi ekonomike zgjedh një format tjetër të pasqyrës së pozicionit financiar nga ai i dhënë në <i>shtojcën 1</i> të këtij Standardi, drejtuesit e kësaj njësie duhet të zgjedhin një format, i cili jep një pamje të vërtetë e të besueshme, referuar Ligjit për kontabilitetin. Institucionet shtetërore duhet të zbatojnë kërkesat e rregullave të përgjithshme të kontabilitetit publik.
	<b>Dallimi mes zërave afatshkurtër dhe afatgjatë të aktiveve dhe detyrimeve</b>
40	Në zgjedhjen e një formati të pasqyrës së pozicionit financiar, të ndryshëm nga ai i përshkruar në <i>shtojcën 1</i> të Standardit, një njësi ekonomike mund ta quajë me vend mosklasifikimin e aktiveve dhe detyrimeve të saj si afatgjata dhe afatshkurtra (për shembull, në rastin e institucioneve financiare ku në përputhje me praktikën ndërkombëtare nuk bëhen dallime të tilla në pasqyrën e pozicionit financiar). Në këtë rast, njësi ekonomike duhet t'i paraqesë aktivet dhe detyrimet e saj në pasqyrën e pozicionit financiar sipas kriterit të likuiditetit.
	<b>Aktivët afatshkurtra</b>
41	Një njësi ekonomike duhet të klasifikojë një aktiv si afatshkurtër kur: (a) pret të realizojë aktivin, ose ka ndërmend ta shesë apo ta konsumojë atë, brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike; (b) e mban aktivin kryesisht për qëllime tregtimi; (c) pret të realizojë aktivin brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së raportimit; ose (d) aktivi është mjet monetar ose një ekuivalent i mjeteve monetare, i pakufizuar për t'u përdorur për shkëmbim ose për të shlyer një detyrim për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së raportimit.
42	Një njësi ekonomike duhet të klasifikojë të gjitha aktivet e tjera si afatgjata. Kur cikli normal i njësisë ekonomike nuk është i identifikueshëm qartë, kohëzgjatja e tij supozohet të jetë dymbëdhjetë muaj.
	<b>Detyrimet afatshkurtra</b>
43	Një njësi ekonomike duhet ta klasifikojë një detyrim si afatshkurtër kur: (a) pret ta shlyejë detyrimin brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike; (b) e mban detyrimin kryesisht për qëllime tregtimi; (c) detyrimi do të shlyhet brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së raportimit; ose (d) njësi ekonomike nuk ka një të drejtë të pakushtëzuar për të evituar shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së raportimit.
44	Njësi ekonomike duhet t'i klasifikojë të gjithë detyrimet e tjera si afatgjata.
45	Një hua me afat maturimi deri në 12 muaj, pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar, do të paraqitet si një detyrim afatshkurtër, përveçse kur në datën e pasqyrës së pozicionit financiar njësi ekonomike ka mundësi ta shtyjë ose ta rifinancojë huanë (për shembull kur është lidhur një marrëveshje përkatëse me bankën ose kreditorin) dhe njësi ekonomike ka në plan ta përdorë këtë mundësi. Megjithatë, nëse njësi ekonomike planifikon ta shtyjë ose rifinancojë huanë, por nuk ka siguri mbi realizimin e këtij plani (për shembull nuk ka ndonjë marrëveshje për të shtyrë ose rifinancuar huanë), kjo hua do të paraqitet si afatshkurtër, edhe nëse pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar huaja shtyhet ose rifinancohet.
46	Kur një njësi ekonomike i ka shkelur kushtet e një marrëveshje të një huaje afatgjatë dhe si rezultat i kësaj huadhënësi ka të drejtë ta kërkojë menjëherë pagesën, atëherë kjo hua do të klasifikohet në pasqyrën e pozicionit financiar si afatshkurtër, edhe pse huadhënësi ka pranuar të mos e përdorë këtë të drejtë.
47	Nëse, në datën e raportimit, një njësi ekonomike ka një marrëveshje detyruese shitjeje për aktive ose një grup të aktiveve dhe detyrimeve, njësi ekonomike duhet të japë informacionet shpjeguese si në vijim: (a) një përshkrim të aktivit ose grupit të aktiveve dhe detyrimeve; (b) një përshkrim të fakteve dhe rrethanave ose planit të shitjes; (c) vlerën kontabël të aktiveve ose, nëse nxjerrja jashtë përdorimit përfshin një grup të aktiveve dhe detyrimeve, vlerat kontabël të këtyre aktiveve dhe detyrimeve.
	<b>Kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve (njohja në shumën neto)</b>
48	Në përputhje me parimin e kompensimit të përshkruar në paragrafët 58 dhe 59 të SKK 1 <i>Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare</i> , aktivet dhe detyrimet do të kompensohen në pasqyrën e pozicionit financiar, vetëm nëse njësi ekonomike ka të drejtë ligjore t'i kompensojë aktivet dhe detyrimet si dhe kur ekziston mundësia që njësi ta përdorë këtë të drejtë. Shumat e kompensuara duhet të jepen për vlerën bruto të tyre tek shënimet shpjeguese..
	<b>PASQYRA E PERFORMANCËS</b>
	<b>Rregulla të Përgjithshme</b>

49	Një njësi ekonomike duhet ta paraqesë performancën e saj për periudhën (sipas shtojcës 2) në: -Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve; -Pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.
50	Në pasqyrën e performancës duhet të përfshihen të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në një periudhë kontabël. Ky standard siguron trajtim të ndryshëm për rrethanat në vijim: (a) Efektet e korigjimeve të gabimeve dhe ndryshimet në politikat kontabël paraqiten si rregullime retrospektive të periudhave të mëparshme dhe jo si pjesë e fitimit ose humbjes në periudhën në të cilën ato lindin (shih paragrafët 94 deri 98 dhe 103 deri 108 të SKK 1 <i>Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare</i> ); (b) Si pjesë e të ardhurave gjithëpërfshirëse, jashtë fitimit/humbjes së vitit, njihen katër lloje të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse; (i) fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga përkthimi i pasqyrave financiare të një veprimtarie të huaj (shih SKK 12 <i>Efektet e ndryshimit të kurseve të këmbimit</i> ); (ii) fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale në vlerë të drejtë sipas trajtimit alternativ të lejuar (shih SKK 5 <i>Aktivitet afatgjata materiale dhe aktivitet afatgjata jo materiale</i> ); (iii) fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga matja me vlerën e drejtë të instrumenteve financiare mbrojtës (shih SKK 3 <i>Instrumentet Financiare</i> ); (iv) disa fitim humbje aktuariale.
51	Emërtimet e zërave duhet të respektohen, megjithëse mund të shtohen zëra të tjerë ose nënkategori të zërave, nëse ato ndikojnë në përmirësimin e qartësisë dhe lexueshmërisë së pasqyrës së performancës. Nënkategoritë e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve mund të paraqiten në shënimet shpjeguese, në vend që ato të paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
52	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve do të tregojë, si minimum, zërat që paraqesin shumat të cilat përbëjnë fitimin ose humbjen siç përcaktohet në një nga formatet e <i>Shtojcës 2</i> të këtij standardi. Fitimi ose humbja do të jetë rreshti i fundit i kësaj pasqyre. Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse do të fillojë me fitimin ose humbjen si rresht të parë të saj dhe do të tregojë, si minimum, zërat që përcaktohen në <i>Shtojcën 2</i> të këtij standardi.
<b>Kërkesat e zbatueshme</b>	
53	Një njësi ekonomike nuk duhet t'i paraqesë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve si zëra të jashtëzakonshëm në pasqyrën e performancës. Një njësi ekonomike jep informacion në shënimet shpjeguese për shumën dhe natyrën e atyre zërave individualë të të ardhurave apo shpenzimeve të cilët janë të jashtëzakonshëm për nga madhësia apo mundësia e ndodhjes.
54	Njësitë ekonomike me interes publik, që zbatojnë këtë standard për paraqitjen e pasqyrave financiare, për shumën e të ardhurave të shfrytëzimit paraqitur në pasqyrën e performancës, japin informacion në shënimet shpjeguese lidhur me ndarjen e saj sipas kategorive të aktivitetit dhe tregjeve gjeografike, për sa kohë këto kategori dhe tregje ndryshojnë ndjeshëm nga njëri tjetri, referuar mënyrës si janë organizuar shitjet e produkteve dhe ofrimi i shërbimeve. Lejohet përjashtimi vetëm në rastet kur një rregullim ligjor apo administrativ e justifikon të dëmshëm për njësinë ekonomike dhënie e këtij informacioni. Në shënimet shpjeguese jepen arsytet përse ky informacion mungon.
55	Një njësi ekonomike duhet të paraqesë analizën e shpenzimeve duke përdorur një klasifikim të bazuar ose në natyrën e shpenzimeve (formati 1 në <i>Shtojcën 2</i> ) ose në funksionin e shpenzimeve (formati 2 në <i>Shtojcën 2</i> ) brenda njësisë ekonomike, duke zgjedhur atë format që siguron informacion më të besueshëm dhe më të përshtatshëm.
56	Në formatin 1 të <i>Shtojcës 2</i> , shpenzimet e shfrytëzimit klasifikohen në bazë të natyrës së shpenzimeve (p.sh. lënda e parë dhe materiale të konsumueshme, shpenzime të personelit, shpenzimet e konsumit dhe amortizimit). Formatin 1 zbatohet përgjithësisht më lehtë, pasi ai nuk kërkon ndarjen e shpenzimeve ndërmjet funksioneve të ndryshme të njësisë ekonomike. Shoqëritë e vogla që nuk kanë nevojë të ndajnë shpenzimet sipas funksioneve, shpesh përdorin Formatin 1, por edhe shoqëri të mëdha në industri të ndryshme sipas praktikës ndërkombëtare zakonisht i përgatisin pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve bazuar në natyrën e shpenzimeve dhe jo në funksionin e tyre.
57	Në formatin 2 të <i>Shtojcës 2</i> , shpenzimet e shfrytëzimit klasifikohen sipas funksionit të shpenzimeve të njësisë ekonomike (p.sh. kosto të shitjes, shpenzimet e shpërndarjes, shpenzimet administrative). Formatin 2 është më i vështirë për t'u zbatuar pasi duhet të merren vendime në lidhje me funksionet e shpenzimeve të shfrytëzimit me të cilat lidhen. Shpenzime të caktuara (p.sh. kostot e personelit) ndahen në mënyrë proporcionale ndërmjet funksioneve të ndryshme. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, e paraqitur sipas formatit 2, ofron një informacion më të mirë të kostos së funksioneve të ndryshme në shoqëri për lexuesit e pasqyrës, në të njëjtën kohë shpërndarja e shpenzimeve sipas funksionit është subjektive dhe pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njësisë të ndryshme të cilat përdorin Formatin 2, nuk mund të jenë të krahasueshme.
58	<i>Shtojca 2</i> e këtij standardi paraqet një numër minimal të zërave të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Përbërja e saktë e zërave të kësaj pasqyre varet nga aktivitetet e njësisë ekonomike dhe praktikës ndërkombëtare në fushën ku kjo njësi operon. Çdo njësi ekonomike duhet të japë në politikat dhe procedurat e saj kontabël përshkrime të hollësishme se cilat të ardhura dhe shpenzime janë përfshirë në zërat përkatës të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Njësia ekonomike duhet t'i përmbahet këtij klasifikimi në mënyrë të vazhdueshme.
<b>Formate të veçanta të pasqyrës së performancës</b>	

59	Në varësi të natyrës së aktivitetit ekonomik (për shembull, shoqëritë e lizingut, organizatat jofitimprurëse dhe institucionet shtetërore), njësia ekonomike raportuese mund të përdorë një format pasqyre performance të ndryshëm nga ai i dhënë në shtojcën 2 të këtij standardi.
60	Zgjedhja e formatit të pasqyrës së performancës, të ndryshëm nga ata të dhënë në shtojcën 2 të këtij standardi, do të bëhet në përputhje me udhëzimet e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit që rregullon këto fusha, si dhe me praktikën ndërkombëtare në këtë fushë. Institucionet shtetërore duhet të përdorin kërkesat e rregullave të përgjithshme për kontabilitetin e sektorit publik.
<b>Kompensimi i të ardhurave dhe shpenzimeve (njohja në shumën neto)</b>	
61	Të ardhurat dhe shpenzimet nuk do të kompensohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, me përjashtim të atyre të ardhurave dhe shpenzimeve që vijnë nga aktivitetet dytësore, apo që kanë ardhur nga një ose disa veprime të ngjashme, apo, që të marra veças nuk janë materiale.
62	Në përgjithësi, të ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen të ndara në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pa i kompensuar me njëra-tjetrën. Të ardhurat dhe shpenzimet, që lidhen me aktivitetet dytësore, mund të kompensohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, nëse kjo jep një pamje më të vërtetë të natyrës së transaksioneve. Shumat e kompensuara duhet të jepen për vlerën bruto të tyre tek shënimet shpjeguese. Më poshtë jepen shembuj të situatave të kompensimit të të ardhurave me shpenzimet ku rezultati njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në shumën neto: (a) fitimet/humbjet, që vijnë nga shitja e aktiveve afatgjata materiale, raportohen në shumën neto (të ardhurat nga shitja e aktiveve afatgjata materiale minus vlerën kontabël neto të aktivitetit); (b) shpenzimet e qirasë të qiramarrësit kompensohen me të ardhurat nga qiraja që gjenerohen nga dhënia e mëtejshme me qira e të njëjtit aktiv (duke supozuar që qiraja nuk është aktivitet parësor i njësies ekonomike); (c) fitimet/humbjet që vijnë nga ndryshimet e kursit të këmbimit raportohen neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve; (d) fitimet/humbjet nga zbatimi i metodës së kapitalit raportohen neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve; (e) fitimet/humbjet nga shitja dhe rivlerësimi i investimeve financiare raportohen neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
<b>PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE</b>	
63	Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare jep informacion në lidhje me ndryshimet në mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare të një njësie ekonomike për një periudhë raportuese, duke treguar veças ndryshimet e aktiviteteve të shfrytëzimit, aktivitetet investuese dhe ato të financimit.
64	Objekti i pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare është të përshkruajë mjetet monetare të gjeneruar e të përdorura nga njësia ekonomike, burimet e financimit dhe ndryshimet në pozicionin e mjeteve monetare si dhe ekuivalentëve të tyre. Informacioni mbi fluksin e mjeteve monetare përbën bazën për vlerësimin e mundësisë së njësies ekonomike për të gjeneruar dhe përdorur mjetet monetare. Shtojca 3 e Standardit jep shembuj të pasqyrave të fluksit të mjeteve monetare të përgatitura sipas metodës direkte dhe indirekte.
65	Ekuivalentet e mjeteve monetare janë investime afatshkurtra, shumë likuide të cilat mbahen më shumë për të përmbushur angazhimet afatshkurtra në mjete monetare sesa për investime ose qëllime të tjera. Prandaj, një investim normalisht kualifikohet si ekuivalent i mjeteve monetare vetëm kur ai ka një maturim të shkurtër (përgjithësisht deri në 3 muaj). Overdraftet bankare konsiderohen normalisht si aktivitete financuese të ngjashme me huadhëniet. Megjithatë, në qoftë se ato janë të ripagueshme dhe formojnë një pjesë integrale të menaxhimit të mjeteve monetare të një njësie ekonomike, overdraftet bankare janë një komponent i mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare.
<b>Fluksi i mjeteve monetare në monedhë të huaj</b>	
66	Një njësi ekonomike duhet të regjistrojë flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga këmbimet, në monedhë të huaj, të monedhës raportuese të njësies ekonomike duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e këmbimit midis monedhës raportuese dhe monedhës së huaj në datën e këmbimit.
67	Njësi ekonomike duhet të përkthejë flukset e mjeteve monetare të një filiali të huaj në monedhën raportuese duke aplikuar kursin e këmbimit të monedhës së huaj në datën e përkthimit.
68	Fitimet dhe humbjet e përcaktuara që rrjedhin nga ndryshimet në kursin e këmbimit të monedhës së huaj nuk konsiderohen flukse të mjeteve monetare. Megjithatë, rakordimi i mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare në fillim dhe në fund të periudhës, efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit në mjete monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare ose të mbajtura në monedhë të huaj, duhet të paraqiten në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare. Prandaj, njësia ekonomike do të vlerësojë mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre të mbajtura gjatë periudhës raportuese (të tilla si shuma të monedhës së huaj të mbajtur dhe llogaritë bankare në monedhë të huaj) me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Njësi ekonomike duhet të paraqesë fitimin ose humbjen që rezultojnë e përcaktuar, veçmas nga aktivitetet e shfrytëzimit, investimit dhe financimit .
<b>Interesi dhe dividendët</b>	
69	Një njësi ekonomike duhet të paraqesë veçmas flukset e mjeteve monetare nga interesi dhe dividendët e marrë dhe të paguar. Njësi ekonomike duhet të klasifikojë flukset e mjeteve monetare në vazhdimësi nga periudha në periudhë si flukse të aktiviteteve të shfrytëzimit, investimit ose financimit.

70	Një njësi ekonomike duhet të paraqesë veçmas flukset e mjeteve monetare nga interesi dhe dividendët e marrë dhe të paguar. Njësia ekonomike duhet të klasifikojë flukset e mjeteve monetare në vazhdimësi nga periudha në periudhë si flukse të aktiviteve të shfrytëzimit, investimit ose financimit.
71	Një njësi ekonomike mund t'i klasifikojë dividendët e paguar si fluks të aktiviteve të financimit, sepse ata përbëjnë koston e sigurimit të burimeve financiare. Ndryshe, njësia ekonomike mund t'i klasifikojë dividendët e paguar si komponentë të flukseve të mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit sepse ato paguhen nga flukse të mjeteve monetare të aktiviteve të shfrytëzimit.
	<b>Tatimi mbi Fitimin</b>
72	Një njësi ekonomike duhet të paraqesë veçmas flukset monetare që vijnë nga tatim fitimi dhe do t'i klasifikojë ato si flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit përveç nëse ato mund të identifikohen në mënyrë specifike të lidhura me aktivitetet e financimit dhe ato investuese. Kur flukset monetare tatimore ndahen në më shumë se një klasë të aktivitetit, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjgues për shumën totale të tatimeve të paguara.
	<b>Aktivitetet e Shfrytëzimit</b>
73	Aktivitetet e shfrytëzimit janë burimi kryesor i gjenerimit të të ardhurave të njësisë ekonomike. Prandaj, flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit zakonisht rezultojnë nga transaksionet dhe ngjarjet e tjera apo rrethanat që përcaktojnë fitimin ose humbjen. Burimet kryesore të flukseve të mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit përfshijnë: (a) arkëtimet e mjeteve monetare nga shitja e mallrave dhe ofrimi i shërbimeve; (b) arkëtimet e mjeteve monetare nga honoraret, tarifat, komisionet dhe të ardhurat e tjera; (c) pagesat në mjete monetare për mallra dhe shërbime; (d) pagesat në mjete monetare për punonjësit; (e) pagesat në mjete monetare ose rifinancimet e tatimit mbi fitimin, derisa të identifikohen specifikisht në aktivitetet financuese dhe investuese; (f) arkëtimet dhe pagesat nga investimet, kreditë dhe kontratat e tjera që kanë të bëjnë ose të mbajtura për qëllime tregtare, të cilat janë të ngjashme me inventarin e blerë për rishitje. Disa transaksione, të tilla si shitja e një pjese të makinerive nga ana e një njësie ekonomike prodhuese, mund të sjellin një fitim/ humbje në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Megjithatë, flukset e mjeteve monetare që lidhen me transaksione të tilla janë flukse monetare nga aktivitetet investuese.
	<b>Raportimi i flukseve të mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>
74	Një njësi ekonomike duhet të paraqesë flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit duke përdorur ose: (a) metodën direkte, ku shpjgohet klasat kryesore të arkëtimeve/ pagesave bruto në pará; (b) metodën indirekte, ku fitimi / humbja e vitit rregullohet për: - efektet e transaksioneve jo monetare; - çdo shtyrje ose rritje të flukseve të aktiviteve të shfrytëzimit, të shkuara ose të ardhshme; dhe - zëra të të ardhurave ose shpenzimeve të lidhura me flukset e aktiviteve investuese ose financuese.
	<b>Metoda Direkte</b>
75	Sipas metodës direkte, fluksi neto i mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit paraqitet në dhënien e informacioneve shpjguese rreth klasave kryesore të arkëtimeve/pagesave bruto siç identifikohet në paragrafin 72. Një informacion i tillë mund të merret ose: (a) nga regjistrat e kontabilitetit të njësisë ekonomike; ose (b) duke rregulluar shitjet, koston e shitjeve dhe zëra të tjerë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve; (i) ndryshimet gjatë periudhës në inventarët dhe të drejtat e arkëtueshme/detyrimet e pagueshme të shfrytëzimit; (ii) zëra të tjerë jo monetarë; dhe (iii) zëra të tjerë për të cilët efektet e mjeteve monetare janë flukse të mjeteve monetare të aktiviteve investuese ose të financimit.
	<b>Metoda Indirekte</b>
76	Sipas metodës indirekte, fluksi neto i mjeteve monetare nga aktiviteti i shfrytëzimit përcaktohet duke rregulluar fitimin / humbjen e vitit për efektet e: (a) ndryshimeve gjatë periudhës në inventarë dhe të drejtat e arkëtueshme/detyrimet e pagueshme të shfrytëzimit; (b) zërave jo monetarë të tillë si shpenzimet financiare jomonetare, shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar, shpenzime konsumi dhe amortizimi, zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale; dhe (c) të gjithë zërat e tjerë për të cilët efektet e mjeteve monetare lidhen me aktivitetet e investimit ose financimit.
	<b>Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti investues</b>



77	<p>Aktivitetet investuese janë blerja dhe shitja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentë të mjeteve monetare. Shembuj të fluksit të mjeteve monetare që rrjedhin nga aktivitetet investuese janë:</p> <p>(a) pagesat për blerjen e aktiveve afatgjata materiale (përfshirë aktivet afatgjata materiale të vetëndërtuara), aktiveve jo-materiale dhe të tjera aktiveve afatgjata;</p> <p>(b) arkëtimet nga shitja e aktiveve afatgjata, aktiveve jo-materiale dhe të tjera aktiveve afatgjata;</p> <p>(c) pagesat në mjete monetare për blerjen e instrumenteve të kapitalit neto ose të borxhit të njësisë të tjera ekonomike dhe interesave në sipërmarrjet e përbashkëta (përveç pagesave për ato instrumente të klasifikuara si ekuivalentë të mjeteve monetare ose të mbajtura për tregtim ose shitje);</p> <p>(d) arkëtimet për shitjen e instrumenteve të kapitalit neto ose të borxhit të njësisë të tjera ekonomike dhe interesave në sipërmarrjet e përbashkëta (përveç arkëtimeve për ato instrumente të klasifikuara si ekuivalentë të mjeteve monetare ose të mbajtura për tregtim ose shitje);</p> <p>(e) paradhëniet dhe huatë e dhëna palëve të tjera;</p> <p>(f) arkëtimet e paradhënieve dhe huave të dhëna palëve të tjera.</p> <p>(g) pagesat në mjete monetare për kontratat e ardhshme, kontratat e përparme, kontratat me opsjon dhe kontratat e shkëmbimit, me përjashtim të rasteve kur kontratat mbahen për tregtim ose marrëveshje të tjera, ose pagesat klasifikohen si aktivitete financimi; dhe</p> <p>(h) arkëtimet në mjete monetare nga kontratat e ardhshme, kontratat e përparme, kontratat me opsjon dhe kontratat e shkëmbimit, me përjashtim të rasteve kur kontratat mbahen për tregtim ose marrëveshje të tjera, ose pagesat klasifikohen si aktivitete financimi;</p> <p>Kur një kontratë trajtohet sipas kontabilitetit mbrojtës (shih SKK3, Seksioni 2 Çështjet e tjera për instrumentet financiare), një njësi ekonomike duhet të klasifikojë flukset e mjeteve monetare të kontratës në të njëjtën mënyrë si flukset e mjeteve monetare të elementit që mbrohet.</p>
	<p><b>Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i financimit</b></p>
78	<p>Aktivitetet financuese janë aktivitetet që rezultojnë në ndryshime në madhësinë dhe përbërjen e kapitalit të kontribuar dhe huamarrjet e njësisë ekonomike. Shembuj të fluksit të mjeteve monetare që rrjedh nga aktiviteti i financimit janë:</p> <p>(a) arkëtimi i mjeteve monetare nga emetimi i aksioneve ose instrumenteve të tjerë të kapitalit neto;</p> <p>(b) pagesa në mjete monetare për blerjen e aksioneve të veta;</p> <p>(c) arkëtimi i mjeteve monetare nga emetimi i titujve të borxhit, afatshkurtër ose afatgjatë;</p> <p>(d) pagesa në mjete monetare të huave dhe kostos së huasë;</p> <p>(e) pagesa në mjete monetare për pakësimin e detyrimit të qirasë financiare.</p>
	<p><b>Raportimi i fluksit të mjeteve monetare nga aktivitetet investuese dhe financuese</b></p>
79	<p>Një njësi ekonomike duhet të paraqesë veçmas klasa të mëdha të arkëtimeve /pagesave bruto të mjeteve monetare që rrjedhin nga aktivitetet investuese dhe financuese. Shuma e fluksit të mjeteve monetare që rrjedh nga blerjet dhe nga shitjet e filialeve ose njësisë të tjera të biznesit duhet të paraqitet veçmas dhe të klasifikohet si aktivitet investuese.</p>
	<p><b>Transaksionet jomonetare</b></p>
80	<p>Një njësi ekonomike duhet të përjashtojë nga pasqyra e fluksit të mjeteve monetare, (aktiviteti investues dhe financues), transaksionet që nuk kërkojnë përdorimin e mjeteve monetare ose ekuivalentëve të mjeteve monetare. Një njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për transaksione të tilla diku tjetër në pasqyrat financiare duke siguruar të gjitha informacionet përkatëse në lidhje me këto aktivitete.</p>
81	<p>Shumë aktivitete investimi dhe financimi nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në fluksin e mjeteve monetare, ndonëse ato ndikojnë në strukturën e kapitalit dhe aktivitetin të njësisë ekonomike. Përjashtimi i transaksioneve jomonetare nga pasqyra e fluksit të mjeteve monetare është në përputhje me objektivin e kësaj pasqyre, pasi këto transaksione nuk shoqërohen me flukse hyrëse ose dalëse të mjeteve monetare. Shembuj të veprimeve jomonetare janë për shembull, blerja e aktiveve nëpërmjet një qiraje financiare si dhe konvertimi i një borxhi në kapital.</p>
	<p><b>Përbërësit e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare</b></p>
82	<p>Një njësi ekonomike duhet të paraqesë komponentët e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare, shumat e të cilave duhet të rakordojnë midis pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrës së pozicionit financiar. Megjithatë, një njësi ekonomike nuk i kërkohej të paraqesë këtë rakordim në qoftë se shumat e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare të paraqitura në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare është e njëjtë me shumën e përshkruar në mënyrë të ngjashme në pasqyrën e pozicionit financiar.</p>
	<p><b>Shënime të tjera shpjeguese lidhur me mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare</b></p>

83	Një njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese, së bashku me një koment nga drejtuesit e saj, mbi shumën e mjeteve të konsiderueshme monetare dhe të gjendjeve të mbajtura nga njësia ekonomike, që nuk janë në përdorim nga njësia ekonomike. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e mbajtura nga njësia ekonomike mund të mos jenë të disponueshme për përdorim nga njësia ekonomike për shkak, midis arsyeve të tjera, edhe të kontrolleve të këmbimeve valutore apo kufizimeve ligjore.
	<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL</b>
84	Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto paraqet fitimin e një njësie ekonomike ose humbjen për një periudhë raportimi, zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në pasqyrën e performancës për periudhën, efektet e ndryshimeve në politikat kontabël dhe korrigjimet e gabimeve të njohura në periudhën, shumat e investimeve, dividendët dhe shpërndarjet e tjera ndaj investorëve të kapitalit neto gjatë periudhës.
85	Një njësi ekonomike duhet të paraqesë një pasqyrë të ndryshimeve në kapitalin neto duke treguar: (a) të ardhurat totale gjithëpërfshirëse për periudhën, duke treguar veçmas shumat totale që i atribuohen pronarëve të njësisë ekonomike mëmë dhe interesave jokontrolluese; (b) për çdo përbërës të kapitalit neto, efektet e zbatimit retrospektiv ose riparaqitjen retrospektive të njohur në përputhje me paragrafët 94 - 98 dhe 103-108 të SKK1 – <i>Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare</i> ; (c) për çdo përbërës të kapitalit neto, një rakordim mes vlerës kontabël në fillim dhe në fund të periudhës, duke shpjeguar veçmas ndryshimet që rezultojnë nga: (i) fitimi/humbja e vitit; (ii) çdo zë i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse; (iii) shumat e investimeve, dividendët dhe shpërndarjet e tjera ndaj pronarëve, duke shpjeguar veçmas emetimin e aksioneve, transaksionet me aksionet e veta si dhe ndryshimet në interesat e pronësisë në filiale që nuk rezultojnë në një humbje të kontrollit.
86	Formati i dhënë në Shtojcën 4 të këtij standardi rekomandohet për përgatitjen e pasqyrës së ndryshimeve në kapital.
	<b>SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE</b>
87	Ky seksion përcakton informacionin bazë themelor që duhet të paraqitet në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare dhe mënyrën e paraqitjes së tij. Shënimet përmbajnë informacion përveç atij që paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare. Shënimet japin përshkrime me fjalë ose zëbra të zërave të paraqitura në këto pasqyra dhe informacione rreth zërave që nuk kualifikohen për njohje në këto pasqyra. Përveç kërkesave të këtij standardi çdo standard tjetër i SKK-ve kërkon dhënie informacionesh shpjeguese përkatëse.
	<b>Struktura e shënimeve shpjeguese</b>
88	Shënimet shpjeguese japin: (a) informacione në lidhje me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikat specifike kontabël të përdorura; (b) informacion shpjegues të kërkuar nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit i cili nuk është paraqitur diku tjetër në pasqyrat financiare; dhe (c) informacion që nuk është paraqitur diku tjetër në pasqyrat financiare por është i nevojshëm për të kuptuar ndonjë prej tyre.
89	Një njësi ekonomike normalisht i paraqet shënimet shpjeguese në rendin e mëposhtëm: (a) një deklaratë që pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; (b) një përmbledhje të politikave kontabël të rëndësishme të zbatuara; (c) informacion mbështetës për zërat e paraqitur në pasqyrat financiare, në rendin në të cilin paraqitet çdo pasqyrë dhe zë përkatës; (d) shënime të tjera shpjeguese.
	<b>Dhënia e informacioneve shpjeguese për politikat kontabël</b>
90	Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues në vijim për përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël: (a) baza e matjes (ose bazat) të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare; (b) politikat e tjera kontabël të përdorura, të rëndësishme për kuptimin e pasqyrave financiare.
	<b>Informacion në lidhje me burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit</b>
91	Një njësi ekonomike duhet të japë informacione në shënimet shpjeguese rreth supozimeve kyçe lidhur me të ardhmen dhe burime të tjera kryesore të pasigurisë së vlerësimit në datën e raportimit, të cilat ka shumë mundësi të sjellin një rregullim material në vlerat kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Përsa i përket këtyre aktiveve dhe detyrimeve, shënimet shpjeguese duhet të përfshijnë detajet e: (a) natyrës së tyre; (b) vlerës së tyre kontabël në fund të periudhës raportuese.

	<b>Shpjegime mbi palët e lidhura</b>	
92	<p>Njësitë konsiderohen të lidhura, nëse njëra palë ose kontrollon palën tjetër, ose ka një ndikim të ndjeshëm mbi palën tjetër. Ndikimi i ndjeshëm ekziston kur ajo lidhet me vendimet financiare dhe ato të shfrytëzimit. Palët janë të lidhura edhe kur ato janë nën kontrollin e përbashkët të një njësie tjetër. Ekzistenca e kontrollit të përbashkët ose ndikimit të ndjeshëm mund të ndikojnë mbi mënyrën se si të dyja palët hyjnë në aktivitete biznesi me njëra-tjetrën. Prandaj, për t'i kuptuar sa më mirë pasqyrat financiare të një njësie ekonomike, duhet të kuptohen mirë marrëdhëniet dhe kushtet, në të cilat palët e lidhura hyjnë në aktivitete biznesi me njëra-tjetrën. Shembuj të palëve të lidhura përfshijnë:</p> <p>(a) njësia mëmë (dhe personat që kontrollojnë ose kanë ndikim të ndjeshëm mbi njësinë mëmë);</p> <p>(b) njësitë e kontrolluara;</p> <p>(c) pjesëmarrjet;</p> <p>(d) sipërmarrje të tjera të të njëjtit grup konsolidimi (për shembull, njësitë e kontrolluara simotra);</p> <p>(e) drejtuesit, anëtarët e organit mbikëqyrës si dhe aksionarët që zotërojnë një pjesë të konsiderueshme të aksioneve, me përjashtim të atyre rasteve kur këta persona nuk e kanë mundësinë praktike të ushtrojnë influencë të ndjeshme mbi vendimet ekonomike të njësisë ekonomike raportuese;</p> <p>(f) të afërmit e ngushtë të personave të përmendur në pikën (e) (përfshirë këtu personat e afërt dhe fëmijët) si dhe njësitë ekonomike që janë nën kontrollin ose ndikimin e tyre.</p>	
93	<p>Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare duhet të paraqitet informacioni i mëposhtëm mbi palët e lidhura dhe veprimet me to:</p> <p>(a) emri i njësisë (për shembull, njësia mëmë ose një person që zotëron shumicën e aksioneve) që kontrollon njësinë ekonomike, si dhe emri i njësisë mëmë që kontrollon të gjithë grupin;</p> <p>(b) llojin dhe volumin e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit si dhe shpërblimin total të dhënë stafit drejtues dhe anëtarëve të organit mbikëqyrës;</p> <p>(c) gjendjen e llogarive ku janë përfshirë transaksionet me palët e lidhura, në datën e pasqyrës së pozicionit financiar;</p> <p>(d) politikat e vendosjes së çmimeve të aplikuara në transaksionet me palët e lidhura.</p>	
94	Një informacion mbi transaksione të veçanta me palët e lidhura duhet të jepet, të paktën për grupet e palëve të lidhura, të përmendura në paragrafin 91.	
95	Transaksionet me njësitë e kontrolluara, që eliminohen gjatë konsolidimit, nuk duhet të shpjegohen në pasqyrat financiare të konsoliduara.	
	<b>DATA DHE RREGULLAT E ZBATIMIT TË STANDARDEVE</b>	
96	SKK 2 <i>Paraqitja e pasqyrave financiare</i> , përditësuar në vitin 2023, do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël që fillojnë më ose pas datës 01.01.2025. Kërkesat e SKK 2 (2023) do të zbatohen në prospektivë.	
	<b>TABELA KRAHASUESE</b>	
97	Tabela më poshtë tregon se si korrespondojnë paragrafët e këtij Standardi me SNRF për NVM (2015). Paragrafët janë konsideruar si korresponduese nëse ato trajtojnë në përgjithësi të njëjtën çështje pavarësisht nga fakti që seksionet e referuara mund të kenë ndryshime.	
	<b>Paragrafët e SKK 2</b>	<b>Paragrafët e SNRF për NVM botuar në korrik 2015</b>
	Paragrafi 1	Asnjë
	Paragrafi 2	Asnjë
	Paragrafi 3	Asnjë
	Paragrafi 4	Sek 4.1, Sek 5.1, Sek 7.3
	Paragrafi 5	Asnjë
	Paragrafi 6	Sek 3.16
	Paragrafi 7	Sek 3.15
	Paragrafi 8	Sek 3.2
	Paragrafi 9	Sek 3.3
	Paragrafi 10	Sek 3.4
	Paragrafi 11	Sek 3.5
	Paragrafi 12	Sek 3.6
	Paragrafi 13	Sek 3.8
	Paragrafi 14	Sek 3.9
	Paragrafi 15	Sek 3.9

Paragrafi 16	Sek 3.11
Paragrafi 17	Sek 3.12
Paragrafi 18	Sek 3.13
Paragrafi 19	Sek 3.14
Paragrafi 20	Sek 3.17
Paragrafi 21	Sek 3.19
Paragrafi 22	Sek 3.20
Paragrafi 23	Sek 3.21
Paragrafi 24	Asnjë
Paragrafi 25	Asnjë
Paragrafi 26	Sek 3.23
Paragrafi 27	Sek 3.24
Paragrafi 28	Sek 3.10
Paragrafi 29	Sek 4.2
Paragrafi 30	Asnjë
Paragrafi 31	Sek 4.3
Paragrafi 32	Asnjë
Paragrafi 33	Asnjë
Paragrafi 34	Asnjë
Paragrafi 35	Asnjë
Paragrafi 36	Sek 4.12
Paragrafi 37	Sek 4.13
Paragrafi 38	Asnjë
Paragrafi 39	Asnjë
Paragrafi 40	Sek 4.4
Paragrafi 41	Sek 4.5
Paragrafi 42	Sek 4.6
Paragrafi 43	Sek 4.7
Paragrafi 44	Sek 4.8
Paragrafi 45	Asnjë
Paragrafi 46	Asnjë
Paragrafi 47	Sek 4.14
Paragrafi 48	Asnjë
Paragrafi 49	Sek 5.2
Paragrafi 50	Sek 5.4
Paragrafi 51	Sek 5.5, Sek 5.9
Paragrafi 52	Sek 5.7
Paragrafi 53	Sek 5.10
Paragrafi 54	Asnjë
Paragrafi 55	Sek 5.11
Paragrafi 56	Sek 5.11

Paragrafi 57	Sek 5.11
Paragrafi 58	Asnjë
Paragrafi 59	Asnjë
Paragrafi 60	Asnjë
Paragrafi 61	Asnjë
Paragrafi 62	Asnjë
Paragrafi 63	Sek 7.1
Paragrafi 64	Asnjë
Paragrafi 65	Sek 7.2
Paragrafi 66	Sek 7.11
Paragrafi 67	Sek 7.12
Paragrafi 68	Sek 7.13
Paragrafi 69	Sek 7.14
Paragrafi 70	Sek 7.15
Paragrafi 71	Sek 7.16
Paragrafi 72	Sek 7.17
Paragrafi 73	Sek 7.4
Paragrafi 74	Sek 7.7
Paragrafi 75	Sek 7.9
Paragrafi 76	Sek 7.8
Paragrafi 77	Sek 7.5
Paragrafi 78	Sek 7.6
Paragrafi 79	Sek 7.10
Paragrafi 80	Sek 7.18
Paragrafi 81	Sek 7.19
Paragrafi 82	Sek 7.20
Paragrafi 83	Sek 7.21
Paragrafi 84	Sek 6.2
Paragrafi 85	Sek 6.3
Paragrafi 86	Asnjë
Paragrafi 87	Sek 8.1
Paragrafi 88	Sek 8.2
Paragrafi 89	Sek 8.4
Paragrafi 90	Sek 8.5
Paragrafi 91	Sek 8.7
Paragrafi 92	Sek 33.2
Paragrafi 93	Sek 33.5, Sek 33.6, Sek 33.9
Paragrafi 94	Asnjë
Paragrafi 95	Asnjë
Paragrafi 96	Asnjë
Paragrafi 97	Asnjë

